



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-3546 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-3546/1 me datë 13.06.2019, dorëzuar nga parashtrues i panjohur, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-3546 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-3546 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-3546 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-3546/1 me datë 15.07.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtrues i panjohur.

Në denoncim filelet për akuza kundër drejtoreshës së SHF , për parregullsi dhe punë jologjore në procedurën për punësim të një personi, në vendin e punës – sekretar i shkollës.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) i merr parasysh të gjitha akuzat e parashtruesit dhe me qëllim të përcaktimit të gjendjes së plotë faktike për këtë rast të denoncuar, KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione deri tek shkolla fillore e lëndës.

Nga procedura e zhvilluar për përcaktimin e gjendjes faktike, KSHPK e konstatoi këtë:

- Në rastin e lëndës bëhet fjalë për akuza për parregullsi dhe punë jologjore në SHF , në procedurën për punësim të një personi në vendin e punës jurist në këtë shkollë, por në atë vend është punësuar person pa përvojë pune edhe sipas akuzës për punësimin e lëndës është i nevojshëm që personi të posedon përvojë pune prej së paku tre vite.

Në denoncim flitet se bëhet fjalë për personin (.....) i cili ka qenë i angazhuar pa shpallur konkurs dhe me të është nënshkruar kontratë e re çdo muaj, në dëm të parashtruesit i cili si i punësuar në shkollën e njëjtë i ka plotësuar kushtet që të konkurojë për këtë vend të punës nëse do të shpallej konkurs për punësim, dhe me këtë gjest i është penguar e drejta për marrëdhënje pune.

- Me datë 21.05.2020, me kërkesë të KSHPK është dorëzuar informimi nga ana e SHF me të cilën dërgojnë edhe shtojcë me dokumentacione

për procedurën e lëndës për punësim të realizuar në periudhën e viteve 2018-2019, dhe në lidhje me vendin e punës jurist – sekretar i shkollës. Nga rishikimi i bërë i dokumentacionit të dorëzuar është konstatuar se:

- Procedura e lëndës për punësim është realizuar për nevojat e shkollës për punësim të një nënpunësi administrativ – sekretar për çështje të përgjithshme dhe normative-juridike – sekretarë, përshkak të kalimit në pension të sekretarit paraprak. Për këtë nevojë është kërkuar pëlqim nga Kryetari i komunës së me datë 12.04.2018, për pranim të punëtorit për çështje urgjente dhe punës që shtyhen për më vonë – finansim i vjetër, që mos të ket ndërprerje në kontinuitetin e punës.
- Me kërkesë të SHF është marrë përgjigje për pëlqimi nga Kryetari komunës së me datë 18.04.2019, në të cilën theksohet se pëlqimi lëshohet për punësim në kohë të caktuar me çka në periudhë ardhshme të zhvillohet procedura në përputhje me Ligjin për punësim në sektorin publik.
- Me datë 25.04.2018, është nënshkruar kontrata për punësim në kohë të caktuar në kohëzgjatje prej tre muaj, gjegjësisht deri në shpalljen e konkursit ashtu siç është e shënuar në kontratën e vulosur me numër arkive OU nr., për kryerje të punëve në vendin e punës sekretar. Kontrata është nënshkruar në mes personit dhe shkollës të përfaqësuar nga drejtori i atëhershëm dhe aktual i shkollës (.....) me të cilën kontratë është krijuar marrëdhënje pune sipas mënyrës dhe kushteve të caktuara nga Ligji për marrëdhënje pune.
- Me datë 12.07.2018, nga ana e SHF deri tek Komuna dhe deri tek Ministria e arsimit dhe shkencës, është dorëzuar kërkesë për marrje të pëlqimit për shpallje të konkursit për vendin e punës sekretar me datë 12.07.2018 dhe është marrë përgjigje për kërkesën me datë 20.07.2018 nga Komuna me të cilën informojnë se është dërguar shkresë nga Ministria e arsimit dhe shkencës, në të cilën komuna kërkon të merr pëlqim për punësim dhe në të cilën e informojnë Ministrinë se e përkrahin kërkesën e SHF për shpallje të konkursit për plotësim të vendit e punës së lëndës në kohë të pacaktuar. Me datë 07.02.2019, deri tek SHF është dërguar informim nga Komuna me të cilën informojnë dhe iu dërgojnë në shtojcë shkrimin e marrë nga Ministria me rishikim të pëlqimit të miratuar për punësim të një personi në vendin e punës – sekretar me datë 09.01.2019, për të cilën është marrë pëlqim edhe nga Ministria e finansave me datë 21.12.2019, e cila është vazhduar të jetë valide edhe në vitin 2019. Për këtë është informuar Komuna me shkrim nga Ministria e arsimit dhe shkencës – Sektori për shkollim fillor me numrin e tyre me datë 05.12.2019 dhe e njëjta është dorëzuar deri tek SHF me datë 11.12.2019.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se në lidhje me akuzat e lëndës në rastin konkret për parregullsi dhe punë joligjore në shkollën fillore të lëndës në procedurën për punësim të një personit në vendin e punës jurist, gjegjësisht procedura e lëndës për punësim është realizuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara me Ligjin për marrëdhënje pune, në kohë të caktuar prej tre muaj dhe për të njëjtën është siguruar pëlqimi nga Kryetari i komunës i nevojshëm për realizimin e punësimit të lëndës, si dhe është bërë procedurë për sigurim të pëlqimit edhe nga Ministria e arsimit dhe shkencës për shpallje të konkursit për

plotёsim tё vendit tё punёs sё lёndёs pёr kohё tё pacaktuar. Duke pasё parasyshtё tё konstatuarёn, KSHPK vlerёson se nuk ka elemente pёr veprim tё mёtutjeshёm pёr rastin e lёndёs, procedura pёr lёndёn tё ndrёpritet kurse lёnda tё mbyllet dhe tё arkivohet.

Nё bazё tё tёrё kёsaj tё shёnuar mё sipёr, Komisioni shtetёror pёr parandalim tё korrupsionit vendosi sipas dispozitave tё kёtij vendimi.

Dorёzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi

Pas pёrfundimit tё KSHPK

Pёrpunoi: J. C., kёshilltarё

Miratoi: V. G., anёtar i KSHPK

**КОМИСИОНИ СШТЕТЌОРОР ПЃР
ПАРАНДАЛИМ ТЃ КОРРУПСИОНИТ**
Zёvendёs-Kryetarё: Shemshi Sallai

